

Fushat e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO),
Liria e lëvizjes ndërmjet qytetarëve



Ky projekt është i mbështetur nga: Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)

Autor: Teuta Hoxha Jahaj

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI) dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Instituti Demokratik i Kosovës dhe Fondacioni Konrad Adenauer i kanë të gjitha të drejtat e rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin domosdo qëndrimet e Institutit Demokratik të Kosovës dhe Fondacionit Konrad Adenauer.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

4

NGRITJA E MIRËQENIES SË SHOQËRIVE TË TË DYJA VENDEVE PËRMES DIALOGUT- REALITET APO PARADOX?

6

Lëvizja e lirë e qytetarëve	6
Çështjet doganore	8
Marrëveshja për reciprocitet të pranimit të diplomave Universitare	9
Memorandumi i Mirëkuptimit për sigurimet e veturave	9
Marrëveshja për përdorimin e tabelave.....	9
Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja rajonale.....	10

ASPIRATAT E KOSOVËS PËR ANTARËSIM NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

12

SHOQËRIA CIVILE SI KATALIZATOR I BASHKËPUNIMIT RAJONAL KOSOVË- SERBI

14

RYCO	14
KOMRA	16

REKOMANDIME

18

Përmbledhje ekzekutive

Dialogu teknik për normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit filloi në vitin 2011, e më pas, nga tetori i vitit 2012 u ngrit në nivel politik me takime mes kryeministrave. Rol kyç në ndërmjetësim ka luajtur BE¹ me ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Deri më tani, janë arritur 33 marrëveshje, kryesisht për çështje teknike, përfshirë marrëveshjen për liri të lëvizjes, pranimin e diplomave universitare, menaxhimin e integruar të kufijve, përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal, regjistrat civil, etj.

Nxitësi kryesor për vazhdim të dialogut ka qenë përafrimi me BE-në, anëtarësimin në të cilën e synojnë që të dyja vendet. BE-ja ka kushtëzuar anëtarësimin e Serbisë me zgjidhje të çështjeve me Kosovën dhe me zbatimin e marrëveshjeve të arritura.² Kurse, në anën tjetër po ashtu, e ka bërë të qartë se progresi edhe do të shpërblehet, siç është rasti me Kosovën, duke nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.³

Përkundër progresit të arritur, gjuha e palëve dialoguese ka qenë përçarëse, herë e kanë vënë procesin në pikëpyetje⁴ e herë kanë kërcënuar se do të dalin nga dialogu.⁵ Fushata e Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare po ashtu ka vazhduar duke i kushtuar Kosovës me mosanëtarësim në organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe INTERPOL. Si përgjigje ndaj kësaj, në nëntor të vitit 2018, Qeveria e Kosovës vendosi taksë për produktet serbe dhe boshnjake, së pari 10% e më pas i ngriti në 100%,

e cila rezultoi në pezullimin e procesit të dialogut. Serbia kushtëzon vazhdimin e dialogut me heqje të taksës⁶, kurse Kosova heqjen e taksës me njohje të Kosovës nga Serbia.⁷

Qytetarët e Kosovës dhe Serbisë në përgjithësi gëzojnë rezultatet në terren, sidomos në aspektin e lëvizjes së lirë. Në përgjithësi, në pikëkalimet kufitare nuk ka më kolona kilometërshe të automjeteve, kurse çmimet e sigurimeve janë ulur dukshëm. Sido që të jetë, kjo gjendje e lehtësuar e lëvizjes së lirë është pre e politikave ditore në Kosovë dhe në Serbi. Si rezultat, qarkullimi i lirshëm i qytetarëve dhe mallrave shumë lehtë mund të bllokohet për shkak të mosbesimit ndërmjet palëve dialoguese. Fërkimet në nivel politik dhe mungesa e transparencës në lidhje me dialogun, domosdo ka reflektuar edhe në perceptimet e qytetarëve të Kosovës ndaj palëve që udhëheqin dialogun dhe vet dialogut në përgjithësi. Në vitin 2019, Qeveria e Kosovës gëzoi më së paku besimin e qytetarëve të Kosovës.⁸ Sipas të dhënave në Barometrin Kosovare të Sigurisë (BKS), qytetarët e Kosovës vazhdojnë ta shohin Serbinë si shtet armiqësor dhe këtë qasje negative kryesisht e bazojnë në tri rryma të ndryshme. Së pari, përmes betejës diplomatike në arenën ndërkombëtare dhe lojës së kompetencave në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Së dyti, prania e Listës Serbe në Qeverinë e Kosovës, që sipas të anketuarve të BKS-së, funksionon nën direktivat e Beogradit dhe përdorë pushtetin politik dhe privilegjet e siguruara nga Pakoja e Ahtisaarit për t'a bërë Kosovën jofunksionale nga brenda, duke

1 https://eeas.europa.eu/diplomatic-network/eu-facilitated-dialogue-belgrade-pristina-relations/349/dialogue-between-belgrade-and-pristina_en

2 <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?l=EN&t=PDF&gc=true&sc=false&f=AD+1+2014+INIT>

3 <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf>

4 Deklarata e Kryeministrit të Kosovës për dialogun, për shkak të temës së shkëmbimit të territoreve me Serbinë

5 Deklarata e drejtorit serb të Zyrës për Kosovën, Marko Gjuriq pas arrestimit të 5 serbëve në Kosovë për vepra antikushtetuese: <https://balkaninsight.com/2018/07/10/serbia-threatens-to-quit-kosovo-talks-over-arrests-07-10-2018/>

6 <https://balkaninsight.com/2018/11/08/vucic-thaci-exchange-angry-statements-after-meeting-in-brussels-11-08-2018/>

7 <https://www.euractiv.com/section/enlargement/neës/kosovo-to-keep-tariffs-until-serbia-grants-recognition-insists-pm/>

8 http://www.qkss.org/repository/docs/BKS2019_874685.pdf

bllokuar pothuajse çdo iniciativë të politikbërjes në shkallë të gjerë. Së treti, retorika agresive nacionaliste nga politikanët serbë ka vërtetuar një nga supozimet më shqetësuese të të anketuarve shqiptarë të Kosovës – kjo riafirmoi faktin se Serbia nuk do ta zbusë qëndrimin e saj ndaj Kosovës në periudhën afatshkurtër.⁹ Ky perceptim i qytetarëve mund të ndryshohet vetëm përmes dialogut gjithëpërfshirës. Politika në Serbi dhe Kosovë, duhet ta shohë dialogun si mekanizëm të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve të tyre dhe jo si garë se kush është fitues. Aspektet pozitive të dialogut dhe qëndrueshmëria e zbatimit të marrëveshjeve arrihet vetëm përmes vetë-reflektimit, si dhe duke adresuar shkaqet kryesore të krizave dhe jo vetëm pasojat e tyre.

Pavarësisht se marrëdhëniet Kosovë-Serbi kanë arritur një stad dialogu dhe bashkëpunimi, sado i brishtë që është ai, bashkëpunimi me qëllim përafrimin e dy popujve, megjithatë ka ekzistuar edhe para dialogut teknik në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Që nga paslufta, OJQ-të, edhe pse me shumë sfida, sidomos në aspektin e lëvizjes së lirë, me ngulm kanë shtyrë përpara agjenda të bashkëpunimit rajonal, duke i bartur më pas në nivel politik, siç është Nisma për KOMRA¹⁰ dhe themelimi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunime Rinore (RYCO).¹¹ Organizatat që kanë pasur ndikim më të madh dhe bashkërendim të përpjekjeve avokuese kanë qenë organizatat me zyra rajonale, që merreshin me tema si ballafaqimi me të kaluarën dhe shkëmbimi i të rinjve. Ndër bashkëpunimet e para dhe më serioze ka qenë Nisma për KOMRA që është iniciuar nga shoqëria civile dhe kishte për qëllim bashkëpunimin rajonal në procesin e ballafaqimit me të kaluarën. Shembull tjetër suksesi i bashkëpunimit rajonal është

organizata Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) e themeluar në vitin 2003, që me zyrat e veta në Serbi, Kroaci, Mal të Zi, Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë ka avokuar për bashkëpunim rajonal midis të rinjve.

Të gjitha këto përpjekje të shoqërisë civile kanë rezultuar me një përkrahje të madhe në procesin e Berlinit¹², që nisi në vitin 2014. Rezultat konkret i këtij bashkëpunimi është themelimi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), që përfshinë pesë qeveritë e vendeve të rajonit në financimin e kësaj iniciative. RYCO u themelua në vitin 2016, ndërsa KOMRA edhe pse nuk arriti të nënshkruhej në Londër, vazhdon të jetë si një ndër opsionet më të mira që do t'i kontribuonte procesit të pajtimit në ish-Jugosllavi. Kjo është konfirmuar edhe në deklaratën e përbashkët të Samitit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në Poznań të Polonisë më 5 gusht 2019¹³, ku vendet pjesëmarrëse kanë konfirmuar përkushtimin e tyre për pajtim, edhe përmes iniciativës KOMRA.

9 http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2018-alb-final-1_657670.pdf

10 KOMRA është një shkurtesë e emrit të plotë të Komisionit Rajonal për Vërtetimin e Fakteve mbi Krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi që nga 1 janari i vitit 1991 deri më 31 dhjetor të vitit 2001. <https://www.recom.link/sq/rreth-nesh-2/sta-je-rekom/>

11 Edhe Nisma për KOMRA edhe përpjekja për themelim të RYCO-s janë iniciuar nga niveli i shoqërisë civile dhe janë bartur në nivel politik për përkrahje. Para votimit nga Kuvendet e vendeve respektive kërkohen nënshkrimet deklarative të përfaqësuesve të shteteve. Për KOMRA kërkohen nënshkrimet e Presidentëve kurse për RYCO ato të kryeministrave.

12 Procesi i Berlinit është një iniciativë që synon të forcojë bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe të ndihmojë integrimin e këtyre vendeve në Bashkimin Evropian. Nisi më 28 gusht 2014, nga Kancelarja Gjermane Angela Merkel. <https://berlinprocess.info/about/>

13 Western Balkans Summit Poznań. Chair's conclusions. RECONCILIATION AND OUTSTANDING BILATERAL ISSUES, Page 9. https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2019/07/chairs_conclusions.pdf

Ngritja e bashkëveprimit të shoqërive të të dyja vendeve përmes dialogut- Realitet apo Paradoks?

Qysh në periudhën e pasluftës, bashkëveprimit me “palën tjetër” i është dhënë konotacion negativ. Duke i shtuar këtu edhe qasjen e politikës dhe disa medie, publiku kryesisht ka qenë i drejtuar tek shembujt negativ të bashkëveprimit ndëretnik. Meqë marrëdhëniet Kosovë-Serbi janë një nga çështjet më të rëndësishme për stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor është realiste të pritët interes i lartë i organizatave dhe fondacioneve ndërkombëtare për të lehtësuar dhe mbështetur proceset e pajtimit dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Shoqëria civile dhe organizatat jo-qeveritare kanë qenë të parat që kanë filluar zvogëlimin e ndasive dhe barrierave, sidomos atyre mendore, tek të dy shoqëritë duke nxitur kështu edhe bashkëpunimin rajonal. Këto nisma kryesisht karakterizoheshin me programe shkëmbimi të të rinjve, të profesionistëve të fushave të caktuara, artistëve, medieve, etj.

Përkundër vullnetit për të tejkaluar barrierat mendore dhe për të përmirësuar marrëdhëniet mes dy vendeve ishin barrierat fizike të natyrës politike që e ngadalësonin procesin. Deri para korrikut të vitit 2008, lëvizja e ligjshme brenda dhe jashtë Kosovës kryesisht qeverisej nga administrata e Kombeve të Bashkuara siç theksohet në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.¹⁴ Dokumentet e udhëtimit lëshoheshin nga UNMIK-u që nga viti 2000, por një gjë e tillë përfundoi me rastin e shfuqizimit të funksioneve administrative të UNMIK-ut, në korrik të vitit 2008. Afati i pasaportave të UNMIK-ut ishte dy-vjeçar, andaj konsiderohet që të gjitha pasaportat e lëshuara nga UNMIK-u do skadonin në vitin 2010.

Në anën tjetër, institucionet kosovare pas shpalljes së pavarësisë filluan të lëshojnë pasaporta dhe dokumente tjera të identifikimit me simbole të Republikës së Kosovës. Sipas ligjit për dokumente të udhëtimit, për kalim të vendkalimeve kufitare dhe si dëshmi e identitetit dhe nënshtetësisë, pasaporta është dokument udhëtimi i lëshuar qytetarëve të Republikës së Kosovës.¹⁵ Në të njëjtën kohë, Qeveria e Serbisë duke e konsideruar Kosovën pjesë të saj ka vazhduar të lëshojë pasaporta edhe pas vitit 1999, përmes operimit të një sistemi paralel shtetëror, me departamente policie, gjykata dhe zyra komunale brenda Kosovës. Si pasojë, deri në vitin 2010, në Kosovë qarkullonin katër lloje të pasaportave: ato të Republikës së Kosovës, UNMIK-ut, pasaportat e vjetra serbe, dhe të reja “biometrike”. Kufizimet e lëvizjes së lirë shkakttoheshin kur qytetarët nuk posedonin dokumentet e duhura të udhëtimit. Në rastet e udhëtimeve, qytetarët me dokumente të UNMIK-ut, fillimisht duhej të kishin ftesë nga organizatori, si dhe arritja e tyre duhej të lajmërohej tek Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, duke specifikuar arsyet e udhëtimit, vendqëndrimin dhe ditët e qëndrimit. Sidomos në rastet e udhëtimeve grupore, kjo procedurë e verifikimit të informatave shkaktonte pritje të stërzgjatura.

LËVIZJA E LIRË E QYTETARËVE

Komplikimet në lëvizjen e lirë bënë që ndër temat e para të dialogut Kosovë-Serbi të jetë lëvizja e lirë e qytetarëve¹⁶. Të dy shtetet u dakorduan që të njihnin dokumentet e udhëtimit të njëra tjetres, përkatësisht

14 http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001_09.pdf

15 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2522>

16 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_freedom.pdf



Afati i pasaportave të UNMIK-ut ishte **dy-vjeçar**, andaj konsiderohet që të gjitha pasaportat e lëshuara nga UNMIK-u do skadonin në **vitin 2010**.

letërnjoftimet, patentë-shoferët dhe certifikatat e lindjes. Pasaportat nuk u përfshinë në marrëveshje, meqë një gjë e tillë mund të nënkuptonte njohjen e shtetësisë së Kosovës. Siç parashihej në marrëveshje, në pikat kufitare serbe, qytetarëve të Kosovës u jepej një dokument për hyrje/dalje, që përmban gjuhë procedurale, me të dhënat e personit dhe lejeqëndrim në Serbi deri në 90 ditë. Të liruar nga pengesat në kufi, shumë të rinj filluan të lëvizin shumë më lirshëm në anën tjetër të kufirit, në shumicën e rasteve për herë të parë, çka ka ndikuar në thyerjen e paragjytimeve ndaj njëri-tjetrit.

Në shtator të vitit 2014 u ngrit niveli i lëvizjes së lirë, duke u mundësuar qytetarëve të Kosovës të kalojnë transit nëpërmjet aeroportit Nikola Tesla në Beograd, për në pika tjera transite për në Bullgari dhe Maqedoni. Më 5 nëntor 2014, pas disa raundeve të vlerësimit të zbatimit të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, ka hyrë në fuqi marrëveshja për hapjen e pikëkalimeve të reja kufitare, të cilat mund të shfrytëzohen nga qytetarët e Kosovës dhe diaspora për kalim transiti nëpër Serbi për në vendet e treta. Këto pikëkalime kufitare janë: pika kufitare në Sid në mes të Serbisë dhe Kroacisë, pika kufitare Kelebija në mes të Serbisë dhe Hungarisë, pika kufitare Gradina në mes të Serbisë dhe Bullgarisë dhe pika kufitare Presheva në mes të Serbisë dhe Maqedonisë si dhe Aeroporti i Nishit.¹⁷ Kurse, linjat ajrore direkte dhe hekurudhore mbeten temë për t'u diskutuar. Progresi i arritur në aspektin e lëvizjes së lirë u komplikua me rastin e tentimit për të arritur

një marrëveshje për tregtinë e lirë. Që nga shpallja e Pavarësisë, Kosova zëvendësoi të gjitha simbolet e UNMIK-ut me simbole të Kosovës. Po ashtu, Kosova zëvendësoi vulat e doganave të UNMIK-ut me vulat e Doganave të Kosovës. Meqë në vula paraqiteshin simbolet shtetërore të Kosovës, Serbia nuk i pranonte dhe vendosi embargo ndaj produkteve kosovare. Në anën tjetër, mallrat e bizneseve të qytetarëve serb qarkullonin lirshëm pasi që ishin pajisur me dokumente nga Administrata Tatimore serbe dhe konsideroheshin si qarkullim i brendshëm dhe jo eksport.

Në raundin e gjashtë të negociatave, të planifikuara për korrik 2011, Kosova dhe Serbia supozohej se do të zgjidhnin, ndër të tjera, mosmarrëveshjet lidhur me mospranimin nga ana e Serbisë të vulave të doganave të Kosovës. Ky takim u anulua nga ndërmjetësuesi, z. Cooper nën arsyetimin se "asnjë marrëveshje nuk do të mund të arrihej", pasi që Serbia e kishte informuar atë me shkrim se nuk ishte e gatshme të merrte pjesë.¹⁸ Dështimi i gjetjes së një gjuhe të përbashkët për zgjidhjen e problemeve rezultoi me vendosje të embargos nga ana e qeverisë kosovare ndaj mallrave serbe dhe boshnjake, si masë reciprociteti.¹⁹ Pasi që hyrjet ilegale të mallrave serbe ndodhnin kryesisht në veri të Kosovës, Qeveria e Kosovës mori vendim që të vendosë kontroll mbi pikat kufitare në Jarinjë dhe Brnjak. Serbët lokal u mobilizuan duke vendosur barrikada për të penguar kalimin e forcave speciale të policisë, me ç'rast një polic kosovar u vra kurse disa të tjerë u plagosën. Pas përprjekjeve për të gjetur zgjidhje, kalimet kufitare u

17 <https://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-serbia-dialog/2520446.html>

18 <http://www.ridea-ks.org/uploads/STUDIMI%20RAPORTET%20BILATERALE%20TREGTARE.pdf>

19 Më 7 dhjetor, 2011, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi mocionin për vendosjen e masave të reciprocitetit me Serbinë si kundërpërgjigje ndaj bllokadës që Serbia u kishte vendosur mallrave nga Kosova. Mocioni u miratua me 42 vota për, 33 ishin kundër, ndërkaq 2 deputetë abstenuan. http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2011_12_07_10_3884_al.pdf



Në shtator të **vitit 2014** u ngrit niveli i lëvizjes së lirë, duke u mundësuar qytetarëve të Kosovës të kalojnë transit nëpërmjet aeroportit Nikola Tesla në Beograd, për në pika tjera transite për në Bullgari dhe Maqedoni.

morën nën kontrollin e përkohshëm të KFOR-it të udhëhequr nga NATO, kurse me tryzni të BE-së palët u rikthyen në tavolinën e diskutimeve.

ÇËSHTJET DOGANORE

Vendosja e embargos nga ana e Serbisë dhe më pas kundërpërgjigja e Kosovës me masa të reciprocitetit obliguan BE-në që të ndërmjetësojë palët në arritjen e një zgjidhje për temat që rregullonin funksionimin e doganave. Marrëveshja u nënshkrua më 2 dhjetor 2011²⁰. Me marrëveshje u larguan edhe embargot tregtare mes Kosovës dhe Serbisë, që ishte hap i mirë për rifillimin e tregtisë. Kjo marrëveshje parashihte edhe mënyrën e menaxhimit të pikave të përbashkëta kufitare (IBM) si dhe ndërtimin e gjashtë pikave të reja kufitare mes Kosovës dhe Serbisë, çka do të avanconte marrëveshjen e lirisë së lëvizjes.

Në aspektin e funksionimit të pikave të përbashkëta kufitare, Kosova dhe Serbia kanë statute të ndryshme për to. Prishtina i konsideron këto vendkalime me Serbinë si vendkalime zyrtare kufitare, dhe ka prezente policinë kufitare, njëjtë si me të gjitha vendkalimet e tjera kufitare të Kosovës. Beogradi në anën tjetër, i konsideron vendkalimet me Kosovën si pika kontrolli kufitar në vijë administrative ndërmjet dy territoreve të saj, duke vendos në këto vendkalime, njësitet e policisë së rregullt. Fakti që autoritetet serbe nuk e njohin IBM si vendkalim kufitar paraqet një problem për qytetarët e huaj të cilët udhëtojnë nga Kosova për në Serbi. Atyre u lejohej të kalojnë në Serbi nga Kosova

nëse pikë e parë hyrëse është përmes vendkalimeve zyrtare me Serbinë. Kjo nuk aplikohet për qytetarët e vendeve të BE-së, BeH, Maqedonisë Veriore dhe Malit të Zi, për shkak të marrëveshjeve që i kanë me Serbinë. Qytetarët e vendeve të tjera kanë 90 ditë që të hyjnë përsëri në Serbi nga Kosova po që se ata kanë hyrë në Kosovë përmes Serbisë dhe nuk janë larguar dhe ri-futur në Kosovë nga çdo vend tjetër. Së fundmi, qytetarët që udhëtojnë jashtë Kosovës dhe kalojnë përmes pikës kufitare të Merdarës dhe Dheut të Bardhë janë përballur me pritje të gjata, për shkak të kontroleve nga pala serbe. Sipas Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar, pritjet në kufi zgjasin deri në 10 orë, andaj autoritetet kosovare u kanë bërë apel qytetarëve të shfrytëzojnë pikat tjera kufitare ku pritjet janë më të shkurtra.²¹

Për dallim nga udhëtarët nga diaspora, qytetarëve kosovarë dhe serbë u është lehtësuar dukshëm qarkullimi dhe atë vetëm përmes letërnjoftimit. Për më shumë zbatimi i marrëveshjes ka pasur një ndikim në rritjen e sigurisë së kontrollit kufitar, bazuar në standardet evropiane dhe praktikatat më të mira të saj. Tutje, mbyllja e pikave të kalimit të paligjshëm në pjesën veriore të Kosovës, ka ndikuar në bashkëpunimin në luftimin e krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe luftës kundër trafikimit ndërkombëtar të narkotikëve.

Pavarësisht qasjes politike ndaj statusit të IBM dhe komplikimeve të shkaktuara nga pala serbe, kjo pikë e marrëveshjes ka vazhduar të implementohet, për dallim nga ajo e krijimit të gjashtë pikave të përhershme të kalimit të përbashkët të IBM

20 Në kontekstin e BE, IBM i referohet "Menaxhimit të Integrimit të Kufijve", kuptimi i akronimit në kontekstin e Dialogu Kosovë-Serbi është diskutabil. Kosova argumenton se IBM nënkupton "Menaxhimin e Integrimit të Kufijve" i cili mbështet ekzistimin e kufijve kombëtar, ndërsa Serbia argumenton se IBM është një "Menaxhim i Integrimit të Kufijve" për një territor pa sovranitet kombëtar.

21 Fluksi në pikat e kalimit kufitar <https://mpb.rks-gov.net/QKMK.aspx>

ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, siç përcaktohet në marrëveshjen e IBM. Sipas Raportit të Progresit të Serbisë për 2019, pala serbe nuk ka pasur angazhim në mënyrë konstruktive në fillimin e vendosjes së pikave të kalimit kufitar në anën serbe (në Jarinjë, Muçibabë dhe Konçul). Kjo gjë çoi në një pezullim të fondeve të BE-së, në korrik 2018. I njëjti dokument thekson edhe refuzimin e palës serbe që të kalojë në objektin e ri në pikë kalimin në Merdare, duke rrezikuar zbatimin e këtij projekti të financuar nga BE-ja. Për më tepër, mos zhvendosja e shtyllave të energjisë elektrike nga pala serbe ka bllokuar edhe palën kosovare që të fillojnë punën për hapjen e pikave në territorin e Kosovës.²²

MARRËVESHJA PËR RECIPROCITET TË PRANIMIT TË DIPLOMAVE UNIVERSITARE

Në frymën e marrëveshjes së lëvizjes së lirë, për lehtësimin e mobilitetit, edukimit dhe punësimit të të rinjve, më 2 korrik 2011, u arrit marrëveshja për diplomatat përmes certifikimit nga një palë e tretë, respektivisht nga Shoqata Evropiane e Universiteteve (EUA). Sipas palës kosovare, përfituesit me të mëdhenj të kësaj marrëveshje ishin studentët nga Lugina e Preshevës të cilët për shkak të afërsisë dhe gjuhës, kryesisht studiojnë në Kosovë. Kjo marrëveshje u kundërshtua nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë, e cila e shpalli atë jokushtetuese, duke potencuar se “qeveria, si organ ekzekutiv, shkoi përtej juridiksionit të saj të përcaktuar me kushtetutë.”²³ Megjithatë në maj të vitit 2016, të dyja palët ranë dakord të rifillojnë zbatimin e marrëveshjes për njohjen e diplomave. Zbatimi i kësaj marrëveshje ka hasur në ngecje, meqë

Serbia kishte njohur vetëm 5 diploma nga Kosova.²⁴ Në anën tjetër, Universiteti i Mitrovicës së Veriut edhe pse nuk është përfshirë në këtë marrëveshje, Qeveria e Kosovës ka aplikuar disa masa afirmative të njohjes së diplomave për arsye të punësimit.²⁵ Kjo përmes emërimit të një Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut.²⁶ Deri në gusht të vitit 2018, janë lëshuar 1,190 certifikata, nga gjithsej 1423 aplikacione të pranuar.²⁷

MEMORANDUMI I MIRËKUPITIMIT PËR SIGURIMET E VETURAVE

Nënshkrimin i MoU²⁸ për sigurimet e veturave që hyri në fuqi më 12 gusht 2015, pas më shumë se tre vitesh negociata, ndikoi në lehtësim edhe më të madh të lëvizjes së lirë të qytetarëve. Kjo marrëveshje e lehtësoi edhe xhepin e qytetarëve në pikat kufitare, duke mos pasur nevojë të blinin sigurim shtesë. Sidoqoftë, kjo marrëveshje nuk përmendte tabelat. Të gjithë qytetarët që hynin në Serbi dhe kishin tabela të Kosovës obligoheshin të blinin afisheet e përkohshme “prova” me çmim pesë euro për ditë qëndrimi në Serbi.

MARRËVESHJA PËR PËRDORIMIN E TABELAVE

Kjo marrëveshje u arrit më 14 shtator 2016²⁹. Përmes saj, palët u dakorduan për reciprocitet në targa mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje i jepte fund targave “të përkohshme – prova” që pala serbe ka

22 <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-serbia-report.pdf>

23 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, rasti: IUO-870/2012 <http://www.ustavni.sud.rs/page/view/sr-Latn-CS/0-101848/zastoj-postupka-u-predmetu-iuo-8702012?qs=metohija>

24 <https://zeri.info/aktuale/128154/serbia-mban-peng-te-diplomuarit-ne-kosove/>

25 http://kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_QRK_-_NR_21-2015_PER_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_PER_LESHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTETASVE_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES_TE_CILET_KANE_MARR.pdf

26 Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, është emëruar nga Qeveria me Vendimin Nr. 08/73, të Datës: 05.02.2016. Komisioni është multietnik dhe përbëhet prej katër (4) anëtarëve: Dy (2) anëtar të propozuar nga Kryeministri, dhe dy (2) anëtar të propozuar nga ministri i MASHT-it. Komisioni është përgjegjës për lëshimin e certifikatave për qytetarët e Kosovës, të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut. [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_73-te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2016_\(3\).pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_73-te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2016_(3).pdf)

27 <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/marreveshja-politike-qe-legalizojte-diplomat-e-universitetit-parallel-te-prishtines/>

28 <http://bks-ks.org/static/uploads/documents/MOU/MoU%20Serbia%20Shq.pdf>

29 http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Arrangements_concerning_the_finalisation_of_implementation_of_2011_freedom_of_movement_-_14_September_2016.pdf

aplikuar në mënyrë të njëanshme për targat RKS të Kosovës që nga viti 2011.

Marrëveshjet e njohura si “Marrëveshjet për kompletimin e zbatimit të Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë të vitit 2011” kanë vendosur reciprocitet në targa mes dy shteteve, duke filluar më 15 nëntor 2016, parasheh përfundimin e targave ilegale në 12 muaj, duke filluar nga 17 janari i vitit 2017 dhe zgjatë periudhën e targave KS për pesë vite. Afati i zbatimit është shtyrë për shkak të vonesave të natyrës administrative nga ana e Kosovës.³⁰ Qeveria e Kosovës kishte përgatitur fillimin e zbatimit të kësaj marrëveshje, duke e miratuar atë përmes një vendimi më 16 shkurt 2017³¹. Ministria e Punëve të Brendshme, mori vendim për zgjatjen e validitetit të tabelave KS dhe filloi me hartimin e udhëzimit administrativ për zbatimin e vendimit të Qeverisë. Po ashtu filluan përgatitjet për zbatimin e letër-ngjithësve që do të mbulonin pjesët specifike të targave të regjistrimeve të automjeteve të Serbisë. Kosova kishte treguar interesim për të arritur reciprocitet në këtë fushë, të normalizonte gjendjen e qarkullimit të veturave në pjesën veriore, ku pjesa dërrmuese e veturave ende janë të paregjistruara apo qarkullojë me targa ilegale. Kjo marrëveshje, me gjasë për arsye të natyrës politike dhe rënies së Qeverisë më 10 maj 2017, nuk është zbatuar nga asnjëra palë. Momentalisht vazhdon gjendja e njëjtë, ku veturat e Serbisë hyjnë të papenguara në Kosovë, ndërsa veturat me regjistrimin RKS duhet të marrin targa provuese.

BASHKËPUNIMI DHE PJESËMARRJA RAJONALE

Deri në shpalljen e pavarësisë, Kosova përfaqësohej nga UNMIK-u në nisma rajonale duke nënshkruar edhe një numër të marrëveshjeve ndërkombëtare. Pas shpalljes së Pavarësisë, Republika e Kosovës trashëgoi marrëveshjet e nënshkruara nga UNMIK-u, përmes Planit të Ahtisaarit³², që ishte zotuar se do t’a zbatonte.³³ Sidoqoftë, Serbia filloi të bllokonte dhe bojkotonte çdo ngjarje ku Kosova përfaqësohej në emër të vet dhe jo përmes UNMIK-ut. Kjo bëri që BE-ja përmes dialogut Kosovë-Serbi të përpiqej të përmirësonte raportet mes tyre, raporte këto që ndiknin direkt në stabilitetin politik, ekonomik e të sigurisë, për gjithë Ballkanin Perëndimor. Në këtë aspekt, palët kishin arritur marrëveshje³⁴, me anë të së cilës Kosovës i mundësohej që të merrte pjesë në nisma rajonale pa u penguar nga Serbia.³⁵ Në këtë marrëveshje Kosova pranoi fusnotën³⁶, çka shkaktoi reagime të ashpra nga opozita në Kosovë duke aluduar heqjen dorë nga subjektiviteti shtetëror dhe ngjalljen e rezolutës 1244.³⁷ Në anën tjetër pala kosovare në dialog argumentonte se mos nënshkrimi i marrëveshjes do e izolonte Kosovën, kurse fusnota, ishte hapje e perspektivës për integritet euro-atlantike.³⁸

Në aspektin e bashkëpunimi bilateral, pas Shqipërisë, Kosova gëzon bashkëpunim të mirë me Maqedoninë e Veriut.³⁹ Menjëherë pas pavarësisë së Kosovës trysnia e Serbisë mbi Maqedoninë ishte e madhe dhe ndikonte në avancimin e marrëdhënieve

30 http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjennezbatimineMarreveshjevetBrukselit_16qershor-25nen-tor2016__New_cMqEfVkj9k.pdf

31 <https://kryeministri-ks.net/qeveria-e-kosoves-mbajti-mbledhjen-e-rregullt-29/>

32 <http://pbosnia.kentlaw.edu/Comprehensive%20Proposal%20for%20the%20Kosovo%20Settlement.pdf>

33 Plani i Ahtisaarit ndër të tjera parashihte një periudhë tranzitore 120 ditëshe për transferimin e përgjegjësive nga UNMIK-u te Qeveria e Kosovës, përfshirë këtu edhe marrëveshjet ndërkombëtare.

34 https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/128138.pdf

35 Fillimisht, Kosova ishte përfaqësuar në forume rajonale nga Misioni i KB në Kosovë. Në vitin 2012, Serbia u pajtua që Kosova mund të veprojë në emër të vetin, me kusht që të përcaktohet si Kosova * me shënimin shoqëruar: “Pa paragjykim për pozicionin e palëve për statusin, në përputhje me 1244 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”

36 Në të gjitha nismat rajonale pas emrit Kosova do të vendoset shënimi: “Pa paragjykim për pozicionin e palëve për statusin, në përputhje me 1244 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”.

37 <https://www.evropaelire.org/a/24490102.html>

38 Intervista e Ministres për Dialog në Qeverinë e Kosovës, Edita Tahiri për Evropa e Lirë: <https://www.evropaelire.org/a/28307242.html>

39 Shih marrëveshjet e nënshkruara: <https://gzk.rks-gov.net/BrowseInstByCat.aspx?Index=1&CatID=2>



Qytetarët e të dyja vendeve ende përballen me regjimin e vizave kurse me vendosjen e tarifës **100% për produktet boshnjake nga ana e Qeverisë së Kosovës, marrëdhëniet mes të dy vendeve janë ftohur edhe më shumë.**

bilaterale mes Kosovës dhe Maqedonisë. Ndryshe nga vendet tjera të rajonit që e njohën Kosovën deri në gjashtë-mujorin e parë të shpalljes së Pavarësisë, Maqedonia e njohu pavarësinë e Kosovës pas tetë muajve. Kjo vonesë erdhi për shkak të trysnisë që Serbia ushtronte mbi politikën maqedonase. Madje, pas njohjes së Kosovë, Serbia e dëboi ambasadorin maqedonas nga Serbia.⁴⁰

Ndikimi serb në politikat e vendeve të rajonit është më se i pranishëm në politikën e Bosnje dhe Hercegovinës. Qëndrimi kundërshtues ndaj pavarësisë së Kosovës i përfaqësuesit serb në presidencën e BeH, ka bërë që Kosova dhe BeH të mos kenë asnjë lloj bashkëpunimi bilateral, madje as prani diplomatike. Qytetarët e të dyja vendeve ende përballen me regjimin e vizave kurse me vendosjen e tarifës 100% për produktet boshnjake nga ana e Qeverisë së Kosovës, marrëdhëniet mes të dy vendeve janë ftohur edhe më shumë.

Në anën tjetër përfaqësuesit e institucioneve kosovare tash një kohë refuzojnë të marrin pjesë në forume të ndryshme ndërkombëtare, ku Kosova përfaqësohet me "fusnotë". Në maj të 2018, Presidenti Thaçi refuzoi pjesëmarrjen në Konferencën vjetore të BERZH-it që mbahej në Sarajevë, meqë Bosnja nuk e ka njohur Kosovën. Në korrik të vitit 2019, Presidenti Thaçi po ashtu bojkotoi

Samitin e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), kurse në dhjetor refuzoi të marrë pjesë në takimin e tretë të shteteve të rajonit për idenë e Mini-Schengenit ballkanik.⁴¹ Kusht i Kosovës për bashkëpunimin rajonal mbetet njohja reciproke e Kosovës nga vendet si Serbia dhe BeH, si dhe implementimi i marrëveshjeve të arritura deri tash me Serbinë. Po ashtu, duhet të theksohet se ndër arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes kosovare në idenë e Mini-Schengenit ballkanik është orientimi i Kosovës drejt NATO e BE-së.

Një marrëveshje si kjo e Mini-Schengenit Ballkanit është ideuar mbi modelin evropian të bashkëpunimit, ndonëse Serbia në vazhdimësi ka mbajtur qasje destruktive ndaj Kosovës edhe përkundër dialogut bilateral të përkrahur nga BE-ja. Duke filluar nga mosnjohja e diplomave, lobimit kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe çnjohjeve të Kosovës, ka arsye të mjaftueshme që pala kosovare e sheh këtë ide si joserioze dhe eksperimentale.⁴²

40 <https://www.dw.com/en/serbia-expels-macedonian-montenegrin-envoys-over-kosovo/a-3704625-1>

41 Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, Presidenti i Serbisë Aleksandar Vučić dhe Kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev kanë zhvilluar dy takime, një në Novi Sad dhe një në Ohër. Pas takimit në Ohër, Qeveria e Maqedonisë së Veriut informoi se baza e deklaratës së përbashkët të miratuar nga shtetet rajonale (për krijimin e Mini schengenit ballkanik) është bashkëpunimi dhe angazhimi i përbashkët në eliminimin e të gjitha pengesave për qarkullim të lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, si kontribut për qytetarët e shteteve të rajonit në realizimin e qëllimit final, anëtarësimin e plotë në BE.: <https://www.koha.net/arberi/188311/zbulohet-deklarata-e-perbashket-e-rames-vuciqit-dhe-zaevit-per-mini-shengen-ballkanik/>

42 Deklarata e Presidentit Hashim Thaçi me rastin e refuzimit të pjesëmarrjes në takimin rajonal të shteteve të Ballkanit Perëndimor: <https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial/posts/3284995644904105>

Aspiratat e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare

Përpjekjet e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare tregojnë se edhe në rrafshin ndërkombëtar Serbia vazhdoi të ketë të njëjtën qasje bllokuese ndaj Kosovës. Nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt të vitit 2008, Kosova është bërë anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe organizatat më të rëndësishme financiare dhe sportive. Anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare paraqitet si prioritet për Qeverinë, Presidencën dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ndonëse anëtarësimi në organizata të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare nuk nënkupton njohje të drejtpërdrejtë të Kosovës si një entitet i ri, përfshirja e Kosovës në to vis-a-vis me shtetet tjera të rajonit, shënon hap të madh përpara. Përmes kësaj Kosova mënjanon izolimin dhe bëhet pjesë e zgjidhjes së problemeve.

Duke mos qenë anëtare formale e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Kosova ka vazhduar aplikimin sidomos në organizata ku anëtarësimi varet nga vullneti i shumicës, apo dy të tretave të shteteve anëtare. Fakti që janë pesë shtete anëtare të Bashkimit Evropian dhe dy anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, ka ndikim të madh krahas lobimit të egër të Serbisë kundër kandidaturave të Kosovës.

Ndër çështjet që ka pasur më së shumti ndikim në marrëdhëniet Kosovë-Serbi është dështimi i Kosovës për anëtarësim në **UNESCO**⁴³ si pasojë e lobimit serb. Për herë të parë për anëtarësim Kosova aplikoi në 2015, dhe dështoi të anëtarësohej për një diferencë prej tri votash. Lobimi i Serbisë në emër të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë, ishte

vendimtar në procesin e vendimmarrjes. Gjatë vitit 2017, zyrtarët kosovarë ndërmorën një tjetër fushatë për të bërë përpjekje për t'u anëtarësuar në UNESCO. Serbia, nga ana tjetër, përdori autoritetin e saj rajonal madje duke kërcënuar me tërheqje të stafit diplomatik serb nga Maqedonia Veriore.⁴⁴ Si rrjedhojë, për të mos shënuar edhe një dështim diplomatik, Kosova vendosi që të tërheqë përkohësisht kërkesën e saj për anëtarësim. Dështimi dytë më i madh diplomatik pas UNESCO-s është ai i **INTERPOL**-it në nëntor 2018, që gjithashtu iu atribuua lobimit serb. Kërkesa e Kosovës që t'i bashkohet INTERPOL-it ka dështuar pasi që nuk mori shumicën e nevojshme, prej dy të tretave të votave të vendeve pjesëmarrëse në Asambleenë e Përgjithshme të kësaj organizate. Si pasojë Kosova mbeti jashtë rrjetit më të madh të shkëmbimit të informacionit kriminal në botë.⁴⁵ Ishin edhe dy herë tjera kur Kosova për shkak të informatave që kishte për mungesë të përkrahjes tërhoqi aplikimet e veta, një në vitin 2017 dhe një tjetër në vitin 2019.

Përderisa Serbia i cilëson këto si fitore diplomatike të saja, lobimi kundër Kosovës tregon qartë se Serbia nuk ka hequr dorë nga qasja destruktive karshi Kosovës, përkundër përfshirjes në një dialog për normalizim të marrëdhënieve me Kosovën. Në anën tjetër, BE-ja si ndërmjetësuese e dialogut nuk ka kritikuar Serbinë, duke e lënë anëtarësimin e Kosovës tërësisht në dorë të qëndrimit të Serbisë. Po ashtu, dështimi i diplomacisë kosovare për një strategji të qartë për anëtarësim, tregoi edhe rëndësinë e ruajtjes dhe thellimit të marrëdhënieve diplomatike me vendet që e kanë njohur Kosovën, e që pritej që do votonin pro anëtarësimit, sidomos në INTERPOL.

43 Organizata Kulturore e Kombeve të Bashkuara u krijua me misionin për të arritur paqen dhe bashkëpunimin midis popujve përmes kulturës, shkencës dhe arsimit.

44 <https://www.reuters.com/article/us-serbia-macedonia-diplomacy/serbia-recalls-embassy-staff-from-macedonia-idUSKCN1B11JO>

45 Në rrethin e parë të votimit, anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL e mbështetën 76 shtete, kundër saj ishin 56 shtete, kurse 22 abstenuan. Ndërkaq, në rrethin e dytë të votimit, Kosova mori 68 vota për, 51 kundër dhe 16 abstenime.



Dështimi i diplomacisë kosovare për një strategji të qartë për anëtarësim, tregoi edhe rëndësinë e ruajtjes dhe thellimit të marrëdhënieve diplomatike me vendet që e kanë njohur Kosovën, e që pritej që do votonin pro anëtarësimit, sidomos në **INTERPOL**. Kosova është njohur nga më shumë se **110 vende** por në rrethin e dytë nuk arriti ti merrte as **70 vota** pro.

Kosova është njohur nga më shumë se 110 vende por në rrethin e dytë nuk arriti ti merrte as 70 vota pro.

Qeveria e Serbisë ka vazhduar dhe ende vazhdon lobimin kundër Kosovës. Për më shumë, vendet që fillimisht e kishin njohur Kosovën kishin filluar të tërhiqnin deklaratat e njohjes.⁴⁶ Përkundër faktit që kjo e fundit u mohua nga diplomacia kosovare, në nëntor 2018, si kundërpërgjigje ndaj qasjes bllokuese të Serbisë, Qeveria e Kosovës kishte vendosur taksën 10% e më pas 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Serbinë në anën tjetër e ka kushtëzuar vazhdimin e dialogut me heqjen e taksës, kurse Kosova kërkon njohje nga Serbia.

Dialogu momentalisht është i ndërprerë, përderisa në Kosovë në fund të vitit 2019 ka pasur zgjedhje parlamentare, andaj ende mbetet të shihet qasja e forcave të reja qeverisëse karshi dialogut. Mos-fillimi i bisedimeve ka thelluar ngrirjen e raporteve, çka ka ndihmuar në mobilizim të mendimit nacionalist dhe largimin e vëmendjes nga kritikrat rreth korrupsionit dhe dështimeve të qeverive.

Gjuha politike e të dy palëve është ashpërsuar, duke rënduar edhe më shumë situatën edhe ashtu të brishtë. Fakti që të dy palët kanë dështuar që të merren seriozisht me krimet e luftës, si dhe me

zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, ka bërë që me raste të mohohen edhe krimet e luftës që janë mirë të dokumentuara, siç është deklarata e Presidentit të Serbisë për masakrën e Reçakut.⁴⁷ Mos stabiliteti i qëndrimeve që e mbizotëron politikën në Kosovë dhe Serbi rrezikon të përshkallëzojë marrëveshjet e arritura deri më tani, për vet faktin se palët kanë fituar "imunitet" edhe ndaj trysnive nga ana e mbështetësve të dialogut. Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë vazhdojnë të insistojnë në pozicionet e tyre, duke kundërshtuar heqjen e pengesave, përkundër thirrjes për rifillim të dialogut nga shtetet e Kuintit. Qeveritë e Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara përmes një deklarate të përbashkët u kanë bërë thirrje palëve dialoguese që të tregojnë vullnet për normalizimin e plotë të marrëdhënieve midis tyre përmes një marrëveshje gjithëpërfshirëse, politikisht të qëndrueshme dhe ligjërisht detyruese që kontribuon në stabilitetin rajonal.⁴⁸

Kosova në njërën anë, përmes fusnotës ka arritur të ketë përfaqësim të barabartë rajonal me vendet tjera të rajonit, siç është rasti me RYCO, dhe në rast të themelimit të KOMRA-s, kurse në anën tjetër Serbia vazhdon të shfrytëzojë pozicionin e vet në rajon dhe ndihmën ruse që të ndikojë në proceset ku përfshihet Kosova.

46 <https://www.koha.net/arberi/100748/media-serbe-pese-shtete-e-kane-terhequr-njohjen-e-kosoves/>

47 Komentet e Vuçiq erdhën pasi Gjykata Themelore e Prishtinës dënoi deputetin serb të Kosovës Ivan Todosijević për nxitje të intolerancës etnike, racore ose fetare duke pretenduar se masakra e Reçakut ishte e fabrikuar: <https://balkaninsight.com/2019/12/06/serbian-president-accused-of-spreading-hate-by-denying-massacre/>

48 <https://rs.usembassy.gov/joint-statement-by-the-governments-of-france-germany-italy-the-united-kingdom-and-the-united-states/>

Shoqëria civile si katalizator i bashkëpunimit rajonal Kosovë- Serbi

Proceset e transformimit të shoqërive të Ballkanit Perëndimor kërkojnë një bashkëpunim të fortë rajonal, një zotim të fortë për bashkëveprim dhe zgjidhje të problemeve të ndërsjella. Në këtë mes, çështja më e mprehtë dhe aktuale është përmirësimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Organizatat jo-qeveritare përmes përpjekjeve të tyre të përbashkëta kanë synuar nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror përmes nismave të krijimit të bashkëpunimeve fillimisht mes shoqërive, e më vonë mes institucioneve. Përmes nismave të tyre rajonale, organizatat joqeveritare kanë dëshmuar se janë promotorët më të mirë të bashkëpunimit ndërkufitar, pajtimit dhe vlerave multietnike dhe ndërkulturore në shoqëri. Në anën tjetër pajtimi si proces i afritit të të dy shoqërive është bazë për sigurinë rajonale dhe gurtëmel i një bashkëpunimi të qëndrueshëm rajonal. Një gjë e tillë u theksua edhe gjatë Procesit të Berlinit, ku themelimi i RYCO-s u nënshkrua në Paris, më 5 korrik 2016, kurse KOMRA mbetet të shqyrtohet në takimet e ardhshme.

RYCO

Përderisa dialogu teknik dhe politik nuk i përfshinte interesat direkte të të rinjve, shumë organizata shfrytëzonin marrëveshjet e arritura për të avancuar agjendat e tyre të bashkëpunimit rajonal. Organizata rinore si Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR)⁴⁹ ka dhënë kontribut të çmueshëm në fushën bashkëpunimit rinor duke realizuar mbi 150

programe të shkëmbimeve me fokus Kosovë- Serbi, me rreth 15,000 nxënës të shkollave të mesme, studentë, juristë, artistë, gazetarë, aktivistë të të drejtave të njeriut, krijues të filmave dhe shkrimtarë.

Ndikimi i avokimit shumë vjeçar erdhi në shprehje gjatë Procesit të Berlinit. Në vitin 2014, kancelarja gjermane Angela Merkel organizoi konferencën që njihet si Procesi i Berlinit⁵⁰, që synonte të tregonte angazhimin e palëkundur politik të Bashkimit Evropian për zgjerimin e ardhshëm të BE-së me Ballkanit Perëndimor. Ky angazhim erdhi si rezultat i rritjes së vazhdueshme të euro-skepticizmit në Evropë dhe pas deklaratës së presidentit të Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, për stopim pesë vjeçar të zgjerimit të BE-së.⁵¹

Me përfshirje në Procesin e Berlinit, Kosova dhe Serbia, u pajtuan për forcimin e marrëdhënieve të tyre në nivel të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Fokus të veçantë u është kushtuar të rinjve, temë të cilën që të dy palët kishin dështuar t'a përfshinin në marrëveshjet bilaterale. Nisur nga praktikat konkrete të organizatave rinore, dhe të frymëzuar nga përvoja e Zyrës Rinore Franko-Gjermane, e themeluar në vitin 1963, pesë vendet e Ballkanit Perëndimor, pjesëmarrëse të Procesit të Berlinit nënshkruan themelimin e RYCO.⁵² Kjo ka qenë hera e parë që qeveritë janë bashkëpunuar si pjesë e një institucioni që, ata do t'a financojnë së bashku. Marrëveshja rajonale e arritur për themelimin e RYCO-s potencon se synimi i zyrës është edhe krijimi i "vetëdijes për

49 YIHR është organizatë rajonale e themeluar në vitin 2003 dhe ka zyre në Serbi, Kroaci, Mal të Zi, Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë

50 Procesi i Berlinit është një koalicion në zgjerim i 10 vendeve të BE-së që bashkëpunojnë me shtetet e Ballkanit Perëndimor, për të shtyer përpara zhvillimin e këtij të fundit. Format i fillestar përbëhej nga Austria, Kroacia, Gjermania dhe Sllovenia, dhe më vonë u bashkuangjiten Franca, Italia, Mbretëria e Bashkuar, Polonia, Greqia dhe Bullgaria. Pas samitit të parë në Berlin në 2014, takimet vjetore të njëpasnjëshme të liderëve të këtyre vendeve u mbajtën në Vjenë, Paris, Trieste, Londër dhe Poznań.

51 President-elect Juncker's Main Messages from his speech before the European Parliament https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/juncker-political-guidelines-speech_en.pdf

52 Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor në Ballkanin Perëndimor <https://www.rycowb.org/wp-content/uploads/2017/07/Agreement-on-the-establishment-of-the-RYCO-sign%C3%A9.pdf>



Numri i përgjithshëm i aplikacioneve të paraqitura për thirrjen e hapur 2018 është **278**, që krijoi gati **900** partneritete në të gjithë rajonin, ndërsa numri i përgjithshëm i aplikacioneve të paraqitura në thirrjen e fundit në 2019 është **100 sosh**, përmes së cilave u krijuan **211** partneritete në rajon.

të kaluarën” tek të rinjtë, kurse vëmendja kryesore fillimisht i kushtohej fushave të edukimit, ekonomisë, shkencës, kulturës, etj. Në samitin e Triestes, vizioni i RYCO-s u plotësua dhe pajtimi mes vendeve të rajonit u radhit ndër tre aktivitetet kryesore të zyrës.

Buxheti vjetor i RYCO-s është përcaktuar të jetë dy milion euro, gjysma e të cilave do të financohen nga qeveritë nënshkruese dhe gjysma nga donacionet. Megjithatë Kosova ende nuk njihet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, ajo ka kontribuar në të gjitha grupet punuese për krijimin e bazës ligjore dhe hartimit të dokumenteve të RYCO-s, si palë e barabartë me vendet tjera dhe ka ndarë buxhetin e saj obligativ për këtë zyrë prej rreth 100 mijë eurove.⁵³ Në anën tjetër, marrëveshja për krijimin e RYCO-s është formuluar me kujdes si një deklaratë e përbashkët mes “Kryeministrave të pjesëmarrësve të Ballkanit Perëndimor”, duke shmangur çdo fjalë që do të afirmonte ose mohonte pretendimin e Kosovës për shtetësi.

Për më shumë, Kosova në RYCO përfaqësohet me fusnotë, kjo si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes

së arritur mes Kosovës dhe Serbisë në lidhje me mënyrën me të cilën Kosova do të përfaqësohet në takimet rajonale⁵⁴. Vendosja e fusnotës ishte pikë shërri gjatë diskutimit në Kuvendin e Kosovës si dhe rrezikonte votimin e RYCO-s.⁵⁵ Lidhur me këtë, para miratimit të këtij projektligji Kuvendi miratoi edhe një deklaratë përmes të cilës Kuvendi e njihte Kosovën vetëm në bazë të emrit të saj kushtetues si Republikë e Kosovës dhe se kjo deklaratë do t’i bashkëngjitej secilës marrëveshje ndërkombëtare që ratifikohet në Kuvend në të ardhmen.⁵⁶ Si rezultat, me 30 mars të vitit 2017, Kuvendi i Kosovës me 82 vota për, 10 kundër dhe 1 abstenim ka miratuar Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë.⁵⁷

Numri i përgjithshëm i aplikacioneve të paraqitura për thirrjen e hapur 2018 është 278, që krijoi gati 900 partneritete në të gjithë rajonin, ndërsa numri i përgjithshëm i aplikacioneve të paraqitura në thirrjen e fundit në 2019 është 100 sosh, përmes së cilave u krijuan 211 partneritete në rajon. Organizatat nga

53 Në bazë të Strategjisë për rininë 2019-2023, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve do kontribuoj në RYCO me 500.000 euro, pra, deri në 5 Organizata Rinore në vit x deri në 20.000 Eur: https://ëëë.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Rini-2019-2023.pdf

54 Fillimisht, Kosova ishte përfaqësuar në forume rajonale nga Misioni i KB në Kosovë. Në vitin 2012, Serbia u pajtua që Kosova mund të veprojë në emër të vetin, me kusht që të përcaktohet si Kosova * me shënimin shoqërues: “Pa paragjykim për pozicionin e palëve për statusin, në përputhje me 1244 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”

55 http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_03_30_10_6926_al.pdf

56 https://www.botasot.info/media/botasot.info/images/2017/March/30/auto_unnamed_11490873296.jpg

57 Me 30 mars 2017, Kuvendi i Kosovës me 82 vota për, 10 kundër dhe 1 abstenim ka miratuar Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14610>

Kosova nga gjithsej 10 projekte ku janë liderë, 7 prej tyre i kanë në partneritet me organizatat serbe.⁵⁸ Ndonëse ende është herët të flitet për ndikimin e këtyre projekteve të financuara nga RYCO, krijimi i një numri kaq të madh të bashkëpunimeve rajonale është tregues mjaft i mirë për efektet pozitive që ka RYCO.

Përkundër qasjes pozitive që RYCO ka në raport me palët nënshkruese dhe rinisë në përgjithësi, duhet të gjinden mekanizma që e pavarësojnë RYCO-n nga shtetet kontribuese, në aspektin e vendimmarrjes sepse në të kundërtën shtetet mund të bllokojnë punën e RYCO-s. Shembull i tillë ka ndodhur në vitin e kaluar përderisa Kosova kryesonte presidencën e RYCO-s, dhe takimi ishte caktuar të mbahej në ndërtesën e Parlamentit të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, Qeveria e Serbisë vendosi që pa paralajmërim të shkarkojë përfaqësuesen rinore, pasi ajo tregoi gatishmërinë e saj për të marrë pjesë në një takim ku shfaqeshin simbole të Qeverisë së Kosovës, të cilat Serbia nuk i njeh si të ligjshme. Si rezultat i shkarkimit të Milica Skiljevic, në mbledhjen e Bordit në Prishtinë nuk pati kuorum për të diskutuar buxhetin për vitin 2019, si dhe vendimet për funksionimin i brendshëm i organizatës.

Përkundër faktit që BE siguron fonde për RYCO-n dhe e sheh bashkëpunimin e të rinjve si thelbësor për zhvillimin e rajonit dhe për të nxitur një tolerancë më të madhe në rajon⁵⁹, ky hap ka kaluar pa shumë vërejte. Çuditërisht, përkundër kërkesave nga ana kosovare për reagim nga BE-ja për shkelje flagrante të marrëveshjeve të arritura gjatë dialogut Kosovë-Serbi⁶⁰ një gjë e tillë nuk ndodhi. Mediat në Kosovë duke u thirrur në posedimin e korrespondencave mes Bordit të RYCO-s dhe Zyrës së Komisionarit për Zgjerim, Johannes Hahn, kanë kritikuar Komisionin Evropian se po e kursen Serbinë nga kritikën, duke i bllokuar deklaratat kundër saj. Sipas po të njëjtave burime, si pretekst për bllokimin e deklaratës, është përdorur mungesa e dokumentit që rregullon

procedurat e Bordit Këshillëdhënës dhe mungesa e konsensusit. Por, anëtarët e Bordit i kanë mohuar arsyetimet e dhëna nga Komisioni, duke e kritikuar atë për ndërhyrje në punën e tyre⁶¹.

Pavarësisht nënshkrimit të shumë marrëveshjeve për përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë- Serbi, si dhe formatit në të cilat është nënshkruar RYCO, janë raste si këto që tregojnë se edhe projektet e mëdha, idetë e mëdha mund të bien pre e politikave me mendësi regresive, kurse vet ekzistenca dhe qëndrueshmëria e RYCO-s mund të vihet në dyshim. Kjo situatë kërkon angazhim të shoqërisë civile dhe vendeve iniciuese të Procesit të Berlinit për të ndihmuar RYCO-n, sidomos duke kërkuar nga palët nënshkruese mbajtjen e përgjegjësisë dhe me ngulm të marrin seriozisht angazhimin dhe zotimin që e kanë bërë në mbrojtjen e vlerave që përfaqëson RYCO dhe duke mos lënë hapësirë për promovimin e interesave të veçanta.

KOMRA

Një ndër temat shumë të rëndësishme që nuk është përfshirë në procesin e dialogut është çështja e ballafaqimit me të kaluarën. Kjo ka bërë që të dyja shoqëritë të krijojnë narrativë të njëanshme për një të kaluar të përbashkët, ku kryesisht “kriminelët” janë në anën e palës tjetër. Gara se kush ka numër më të madh të viktimave respektivisht kush është më “viktimmë” është tejet e pranishme në të dyja shoqëritë. Kjo për shkak të mungesës së fakteve dhe regjistrave të dëmeve të luftës. Në vitin 2007, FDH (Fondi për të Drejtën Humanitare-Serbi), Qendra Hulumtuese – Dokumentuese (QHD-BeH) dhe Dokumente, publikuan idenë për themelimin e Komisionit Rajonal për Mbledhjen dhe Vërtetimin e Fakteve për Krime Luftë. Ky komision do të ndihmonte punën e prokurorive në rajon me anë të mbledhjes, shfrytëzimit, organizimit dhe ruajtjes së evidencës që do të mund të përdorej për iniciimin

58 Informacion i marrë nga zyra e RYCO-s në Prishtinë

59 https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

60 https://twitter.com/Enver_Hoxhaj/status/1105805923543584768?s=20

61 <https://www.koha.net/arberi/151805/komisioni-evropian-e-kursen-serbine-blokon-deklaratat-kunder-saj/>

dhe ushtrimin e procedurave penale për krime lufte. Njëherit, ky Komision do regjistronte emër për emër të gjitha viktimat e luftës.

Nismën për themelimin e Komisionit Rajonal për Mbledhjen, Vërtetimin dhe Shpalosjen e Fakteve për Krime Lufte në ish-Jugosllavi e kanë përkrahur shoqatat dhe asociacionet e viktimave dhe të veteranëve, organizatat e të rinjve dhe ato për të drejtat e njeriut, artistët, shkrimtarët dhe gazetarët në rajon, të cilët kanë marrë pjesë në konsultime rajonale të shoqërisë civile mbi mekanizmat për vërtetimin e fakteve për të kaluarën, që kanë nisur në maj të vitit 2007 në Sarajevë. Po ashtu, është themeluar Koalicioni për KOMRA i cili ka organizuar fushatën për mbledhjen e një milion nënshkrimeve për themelimin e KOMRA-s dhe më pas, duke e bashkangjitur edhe rekomandimin e shoqërisë civile, kjo nismë u është dërguar qeverive kombëtare së bashku me kërkesën për nxjerrjen e vendimit mbi përkrahjen e nismës.⁶² Koalicioni për KOMRA përfshin mbi 1,600 organizata dhe individë. Në një koalicion kaq të gjerë priten pikëpamje të ndryshme mbi metodat për të arritur një qëllim të përbashkët. Gjatë gjithë këtyre viteve, organizata dhe individë të ndryshëm i bashkohen çdo ditë Koalicionit, por edhe i janë larguar për arsye të ndryshme.

Pas themelimit të RYCO-s në Paris, si pjesë e procesit të Berlinit, takimi i ardhshëm në Londër ishte shpresë për organizatat e shoqërisë civile që kishin kaluar vite të avokimit për themelimin e KOMRA-s. Premtimi i dhënë nga Presidentët e Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë që Kryeministrat e këtyre vendeve të do të nënshkruanin Deklaratën për Themelimin e KOMRA në Samitin e Londrës më 10 korrik të vitit 2018 nuk ka prodhuar rezultatet e pritshme. Deri më 7 korrik të vitit 2018, Koalicioni nuk kishte marrë konfirmimet e qeverive të të gjitha vendeve të lartpërmendura, çka detyroi organizatorët ta hiqnin nga agjenda nënshkrimin e deklaratës së themelimit⁶³.

Kjo edhe njëherë dëshmon se shtetet e ish-Jugosllavisë ende nuk janë të gatshme të adresojnë trashëgiminë e luftës, por po ashtu edhe vuri në pah mungesën e një programi konkret për adresimin e krimeve të luftës, nga ana e vetë BE-së.

Mos nënshkrimi i themelimit të KOMRA-s u jep shpresë vetëm elitave politike që ende funksionojnë në bazë të ideologjive nacionaliste duke mos larguar nga radhët e veta personat e akuzuar apo potencialisht të akuzuar për krime lufte, kurse 18 milion banorë mbesin peng i mosndëshkueshmërisë dhe në ankth të rikthim të ciklit të dhunës.

62 Nisma për themelimin e Komisionit Rajonal për Vërtetimin dhe Shpalosjen e Fakteve për Krime Lufte [KOMRA], qershor 2008.

63 <https://www.recom.link/london-summit-without-the-declaration-on-recom/>

Rekomandime

- Dialogu politik i nivelit të lartë midis Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë, qoftë edhe **me ndryshim të qasjes apo formatit të negociatorëve**. Sipas Barometrit Kosovar të Sigurisë 2019, Qeveria e Kosovës gëzon më së paku besim tek qytetarët e Kosovës, në anën tjetër qytetarët nuk mendojnë që shkëmbimi i pjesës veriore të Kosovës me pjesën jugore të Serbisë ofron zgjidhje afatgjate mes Kosovës dhe Serbisë. Andaj, krijimi i një ekipe gjithëpërfshirëse profesionale, caktimi i kohëzgjatjes së dialogut dhe agjendës do të sillte klimë pozitive dhe siguri tek qytetarët e të dyja vendeve. Duke pasur parasysh ngecjet e zbatimit të marrëveshjeve, **rivlerësimi** i këtyre marrëveshjeve nuk duhet të hiqet nga konsiderata.
- **Unifikim politik rreth prioriteteve dhe pritjeve nga dialogu.** Tema e shkëmbimit të territoreve të cilën e proklamonte Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, si dhe kundërshtimi kategorik ndaj kësaj teme i Kryeministrit Haradinaj ka vënë në pah polarizimet brenda spektrit politik të Kosovës, duke mos u treguar serioz karshi dialogut dhe aleatëve ndërkombëtarë. Po ashtu, mungesa e bashkërendimit të interesave nacionale dhe dialogut të brendshëm kanë ndikuar në rritjen e mostransparencës së dialogut çka ka rezultuar në rritjen e mosbesimit qytetar ndaj vet dialogut.
- **Temat e dialogut duhet të zgjerohen** për të përfshirë çështje të rëndësishme për normalizimin e jetës së qytetarëve të të dyja vendeve, siç janë personat e zhdukur, bashkëpunimi në procesimin e krimeve të luftës dhe trashëgimia kulturore, tema që u anashkaluan në raundet e mëparshme të dialogut.
- **Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë duhet të rrisin transparencën** për marrëveshjet e arritura deri tash dhe nivelin e përmblidhjes së tyre. Publikimi i dokumenteve autentike dhe raporteve qeveritare për zbatimin e marrëveshjeve do t'i ulte dilemat dhe do t'a largonte konfuzionet rreth përmblidhjeve të marrëveshjeve për të dy shoqëritë.
- **Bashkimi Evropian duhet të vendosë mekanizma** që garantojnë zbatimin e marrëveshjeve të arritura.
- Qeveria e Kosovës duhet të marrë vendim për **përsheptimin e procedurave** në marrjen e vendimit të hapjen e procedurave për furnizim me afishe ("stickers") dhe urdhërimin e Policisë Kufitare për fillimin e zbatimit në plotni të marrëveshjen për avancimin e lirisë së lëvizjes të vitit 2016.
- **Palët duhet të avancojnë marrëveshjen e lirisë së lëvizjes** në favor të shtetasve të huaj që dëshirojnë të futen në Serbi përmes Kosovës. Këtu duhet pasur parasysh edhe çështjen e udhëtimit ajror dhe atij hekurudhor.
- Palët dialoguese duhet **të përfshijnë interesat e të rinjve** të të dyja vendeve në proces. Kosova vlerësohet se ka përqindjen më të madhe të të rinjve në rajon të grupmoshës prej 18-35 vjeç, porse interesat e tyre nuk janë të përfaqësuara direkt në dialog. Përfshirja e të rinjve në tryezën e dialogut ka rëndësi të veçantë për vet faktin se ata preken direkt nga vendimet që do të merren në tryezën e dialogut por po ashtu përfshirja e të rinjve gjatë të gjitha fazave të procesit të dialogut mund të rrisë qëndrueshmërinë e rezultateve. Kjo mund të bëhet përmes disa formave, qoftë përmes forumit

kombëtar rinor, ku të rinjtë nga fusha të ndryshme profesionale mund të adresojnë problematikat e tyre tek ekipi negociator, apo përmes rrjetëzimeve të organizatave rinore dhe adresimit të çështjeve me rëndësi tek ekipi negociator. Po ashtu, palët duhet të vlerësojnë si pozitive marrëveshjen e nënshkruar në kuadër të Procesit të Berlinit, që ndikon direkt në bashkëpunimet rinore të të dyja vendeve. Përpos ndarjes buxhetore vjetore, palët duhet të garantojnë që RYCO nuk do të bie pre e acarimeve të raporteve mes qeverive.

- **Kosova duhet të draftojë një strategji diplomatike gjithëpërfshirëse** dhe të koordinuar për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare dhe nismat rajonale.
- **Qeveria e Serbisë duhet të zbatojë marrëveshjen për diplomat**, duke iu mundësuar të rinjve të Luginës së Preshevës kushte të favorshme të punësimit.

